

VENDIM
Nr.849, datë 14.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 2.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2011, PËR
BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E
MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin, nga Buxheti i Shtetit, të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në pikën 1 të vendimit nr.160, datë 2.3.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a” shifra 31 632 000 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë bëhet 30 478 175 (tridhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

2. Në nënndarjen “i” të shkronjës “a” shifra 16 758 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë bëhet 15 604 175 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

3. Në shkronjën “b” shifra 26 220 000 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e njëzet mijë) lekë bëhet 26 158 675 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

4. Në nënndarjen “i” të shkronjës “b”, shifra 21 660 000 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë bëhet 21 598 675 (njëzet e një milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

5. Në shkronjën “c” shifra 25 878 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë bëhet 25 816 675 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

6. Në nënndarjen “i” të shkronjës “c”, shifra 4 332 000 (katër milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë) lekë bëhet 4 270 675 (katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

7. Në shkronjën “ç” shifra 16 270 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë bëhet 17 546 475 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

8. Në nënndarjen “i” të shkronjës “ç”, shifra 3 762 000 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë bëhet 2 693 975 (dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

9. Në nënndarjen “ii” të shkronjës “ç”, shifra 8 508 000 (tetë milionë e pesëqind e tetë mijë) lekë bëhet 10 852 500 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha